



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË SH.A

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Vlorë më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2024

*Shtojca 12*

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

*Dt.21.10.2024*

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik KREATEX sh.p.k  
(Adresa:Rr. Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra Nr. 2, Tiranë, Shqipëri)

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedure e Hapur e Thjeshtuar Sherbime**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Mirëmbajtje e sistem faturimi, arkëtimi dhe fiskalizim fature”** me nr **Ref-13075-07-12-2024** me fond limit: **10,000,000** ( dhjete milion ) **Lekë pa tvsh.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. InfoSoft Business shpk

*Emri i plotë i shoqërisë*

NIPT: L02214022G

*Numri i NIPT-t*

**Vlera: 8 800 000** (tete milion e teteqind mije) **Lekë pa TVSH;**  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

2. KREATEX sh.p.k

*Emri i plotë i shoqërisë*

L12121023B

*Numri i NIPT-t*

**Vlera: 9 500 000** (nëntë milion e pesëqind mijë) **Lekë pa TVSH**  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

3. TETRA PRO shpk

M22121029F

**Emri i plotë i shoqërisë**

**Numri i NIPT-t**

**Vlera: 9 900 000** (nëntë milion e nentëqind mijë) **Lekë pa TVSH**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. InfoSoft Business shpk

NIPT: L02214022G

**Emri i plotë i shoqërisë**

**Numri i NIPT-t**

**Vlera: 8 800 000** (tete milion e teteqind mije) **Lekë pa TVSH;**

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

Bazuar ne dokumentacionin e ngarkuar ne SPE, operatori ekonomik skualifikohet per arsyet si meposhte :

- 1- OE ka paraqitur ne SPE Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit i cili nuk eshte plotesuar ne menyre te plote dhe shteruese sic ligji e parashikon dhe gjithashtu sipas vendimarrjes unifikuese te KPP me konkretisht vendimi Nr. 1192/2024, date 04.09.2024. Gjate shqyrtimit te formularit permbledhes te vetedeklarimit konstatojme qe OE ka plotesuar kete formular duke vetedeklaruar dhe duke dhene informacion te pjesshem vetem per seksionin "*Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*" dhe kete seksion e ka plotesuar vetem me emrat e personave qe ndodhen ne cilesite e parashikuara nga ky paragraph dhe nuk eshte cituar dokumentacioni dhe menyra e verifikimit te tij. Gjithashtu AK konstaton qe ky formular permbledhes vetedeklarimi nuk permban per seksionet dhe paragrafet e tjera qe lidhen drejtpersdrejti me kriteret e pergjithshme te kualifikimit asnje citim te dokumentacionit qe verteton deklaratat dhe asnje menyre se si ky informacion mund te verifikohet nga AK. Referuar LPP, Rregullave te Prokurimit Publik dhe vendimarrjes unifikuese te KPP, AK konstaton qe OE nuk ploteson kriteret e pergjithshme te kualifikimit lidhur me plotesimin e sakte te Formularit te Vetedeklarimit sipas kerkesave duke mos dhene informacion dhe indicie per dokumentacionin dhe menyren e verifikimit te tij. OE nuk ka plotesuar nje nga kushtet thelbesore te kesaj procedure qe eshte plotesimi i sakte i Formularit Permbledhes te vetedeklarimit. Ak gjate argumentimit te kesaj arsye skualifikimi ka marre per baze vendimin unifikues te KPP Nr. 1192/2024, date 04.09.2024.
- 2- OE ka deshtuar te permbushe kriterin **2.4.1** i cili parashikon "*Operatori Ekonomik duhet të jetë i licensuar nga AKSHI dhe DPT për sistemin e fiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti të licensuar të fiskalizimit.*". Gjate shqyrtimit te dokumentacionit te ngarkuar ne SPE konstatojme qe per permbushjen e kesaj pike OE ka ngarkuar vetem nje deklarate sipas se ciles deklaron qe eshte i licensuar per sistemin e fiskalizimit por realisht nuk ka te ngarkuar licensen se ciles i referohet. Kujtojme qe kjo licence

dhe referuar kriterit leshohet nga AKSHI dhe DPT dhe eshte nje license qe permban nenshkrimet elektronike te leshuesve te kesaj license. Printscreen i paraqitur nga OE ne kete procedure nuk ka asnje lidhje me certifikikaten e kerkuar nga AK ne kete kriter. Per sa me siper cituam duke patur parasysh qe ky licensim eshte i domosdoshem per realizimin e sherbimeve objekt procedure theksojme qe mungesa e ketij licensimi ne SPE perben kusht per skualifikim.

2. TETRA PRO shpk

M22121029F

*Emri i plotë i shoqërisë*

*Numri i NIPT-t*

**Vlera: 9 900 000** (nëntë milion e nenteqind mijë) **Lekë pa TVSH**  
(e shprehur në shifra dhe fjalë)

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas kerkesave te DST ku thuhet :1.Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur deshmi te ngjashme per sherbimet e ngjashme te kryera gjate tre viteve te fundit sipas kerkesave ne DST ku thuhet se: **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.***Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së së fondit të limit të përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **KREATEX sh.p.k** me NIPT **L12121023B** me adrese: (Rr. Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1, Shkalla 1, Zyra Nr. 2, Tiranë, Shqipëri) , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **9 500 000** (nëntë milion e pesëqind mijë) **Lekë pa TVSH** / totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**ADMINISTRATOR**

**SOKOL KANANAJ**